



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr. 04/21

Datë: 25.01.2021

Në mbështetje të nenit 23 par. 2, neni 28 paragrafi 1 pika 1.7 pika 1.8 pika 1.10 neni 29 Ligjit Nr. 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe Ligji për plotësim ndryshimin e tij Nr. 04/L-226; Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën **25 Janar 2021** jep këtë:

MENDIM PROFESIONAL

- I. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (tutje ref. AUTORITETI), angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të Konkurrencës (Abuzimit me Pozitë Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluar, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të pa autorizuar), nga ndërmarrjet private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga administrata shtetërore dhe entet rregullatore në territorin e Republikës së Kosovës dhe jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.
- II. Autoriteti, thekson se zbatimi i parimit të barazisë është detyrim, ndërsa vlerëson se mos zbatimi i parimit të barazisë, përveç në rastet kur arsyetohet objektivisht, mund të dobësoj pozitën e operatorëve në treg, pra që situatat e krahasueshme të mos trajtohen ndryshe dhe që situata të ndryshme të mos trajtohen në të njëjtën mënyrë, përveç nëse një trajtim i tillë justifikohet objektivisht.
- III. Nga këndvështrimi i politikave të konkurrencës, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të vazhdojë të kujdeset, që gjatë procesit të Planit të Migrimit të Kodeve ekzistuese +377, +381 dhe +386 në Kodin Telefonik Shtetëror +383 të Republikës së Kosovës, të mbizotëroj efekti i “Neutralitetit të konkurrencës” (Parimi i përgjithshëm i trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimit) përmes së cilit sigurohet që subjektet të cilat operojnë në një treg nuk i nënshtrohen favoreve në pikëpamje të konkurrencës.
- IV. Institucionet duhet të jenë në mbrojtje të interesit publik, gjithashtu duhet të kujdesen që të krijojnë ambient të përshtatshëm për operatorët aktual dhe nxitës për hyrjen e operatorëve të rinj në treg. Zbatimi i politikave të neutralitetit konkurrues është e një rëndësie të veçantë në sektorët e rregulluar dhe të liberalizuar. Aplikimi i tyre nga ana e Autoriteteve Publike nënkupton, që përfitimet e konkurrencës do të rriten, andaj adresimi i neutralitetit është një instrument i rëndësishëm i politikës së konkurrencës, që duhet të adresohet për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

